


Raport

mbi vetëdeklarimin e autoriteteve publike

për zbatimin e kërkesave të ligjit
për të drejtën e informimit

2024



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Përmbajtja

HYRJE	2
METODOLOGJIA	4
ANALIZA E TË DHËNAVE	5
GJETJET KRYESORE	7
PËRFUNDIME	9

HYRJE

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) është autoriteti i pavaruar, që monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit bazohet në parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar; ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Aktet e sipërpërmendura, në harmoni edhe me kuadrin ligjor tjetër në fuqi, garantojnë respektimin e këtyre të drejtave individuale të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Nëpërmjet këtij raportimi, Zyra e Komisionerit ka adresuar në mënyrë të standardizuar edhe rekomandimet e SIGMA për vitin 2024: “Ndërkohë, Zyra e Komisionerit (IDP) po mbledh të dhëna për numrin e kërkesave për informacion të trajtuara nga autoritetet publike dhe afërsisht 90% e tyre po i raportojnë këto të dhëna”¹.

Të njëjtin qëndrim ka shprehur edhe raporti i UNCAC (Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftën Kundër Korrupsionit): “Të forcohet raportimi në kohë nga organet publike të Komisioneri për Informim i informacionit mbi zbatimin e ligjit ‘Për të drejtën e informimit’”.

Gjatë vitit 2023, në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”) u bënë disa shtesa dhe ndryshime të rëndësishme, në fokus të të cilave është forcimi i rregullave, mekanizmave dhe procedurave për njohjen me informacionin/dokumentacionin me karakter publik nga qytetarët apo grupet e interesit.

Një ndër këto përmirësime rregullatore është edhe përfshirja në këtë ligj e nenit 24/1 - “**Detyrimi për bashkëpunim**”, i cili shprehimisht parashikon se:

“1. Autoritetet publike bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave.

2. Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri”.

Në zbatim të këtij detyrimi të LDI, Urdhëri i Komisionerit nr. 209, datë 13.12.2024 “Për miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike për vitin 2024 mbi zbatimin e kërkesave të ligjit “Për të drejtën e informimit” (në vijim “Urdhri 209/2024”²) e standardizoi këtë proces.

¹https://www.oecd.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024_5577d117-en.html

²https://idp.al/wp-content/uploads/2025/01/urdher_209_2024_per_miratimin_e_formatit_te_kerkesave.pdf

Raportimi sipas këtij formati i shërben Zyrës së Komisionerit për realizimin e një fotografimi sa më të saktë vjetor, për evidentimin e problematikave që hasin kërkuesit dhe autoritetet publike (në vijim “AP”) në zbatimin e LDI, prirjet në kërkimin e informacionit/dokumentacionit me karakter publik, shkaqet e kufizimit apo dhe kategorizimin/identifikimin e kërkuesve (për aq sa është e mundur).

Bashkëpunimi me Zyrën e Komisionerit sipas nenit 24/1 të LDI përbën një nga mekanizmat më të rëndësishëm për ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim nga qytetarët apo grupet e interesit dhe garantimin e saj në procesin administrativ në përmbushje të qëllimit të LDI.

METODOLOGJIA

Për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor, gjatë muajit janar 2025 Zyra e Komisionerit dërgoi pranë të gjithë koordinatoreve për të drejtën e informimit të AP formularin e raportimit të të dhënave të kërkesave për informacion të marra gjatë vitit 2024. Ky dokument përmban 16 pyetje (disa prej të cilave edhe me nënpyetje), për të identifikuar/saktësuar si të dhënat bazë dhe të përgjithshme (emërtimin e institucionit, faqen zyrtare në internet, apo pasjen e një koordinatori dhe të dhënat e tij/saj të kontaktit), ashtu edhe ato me një natyrë më specifike (që kanë të bëjnë me prirjet e kërkimit të informacionit/dokumentacionit me karakter publik).

Këto të dhëna, kombinuar me monitorimin periodik të “Programit të Transparencës”, “Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve” dhe “Indekset vjetore të transparencës proaktive” të AP japin një panoramë mbi llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e tyre, elemente kyç në funksion të forcimit të transparencës dhe llogaridhënies, për rritjen e besimit të qytetarëve në mirëqeverisje.


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TË DREJTËS PËR INFORMIM
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS
Nr. 2595/Prist. Tiranë, më 13/12/2024
URDHËR
Nr. 209, datë 13.12.2024
PËR
MIRATIMIN E FORMATIT TË RAPORTIMIT TË AUTORITETEVE PUBLIKE
PËR VITIN 2024 “MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR TË
DREJTËN E INFORMIMIT”
Ne mbledhjetje të nenit 24/1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar.
URDHËROJ
1. Miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike për vitin 2024, bashkëlidhur
këtij urdhëri dhe pjesë përshkuese e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, për dërgimin e tij
autoriteteve publike, mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe publikimin e tyre.
Ky urdhër bën në fuqi menjëherë.
KOMISIONERI
Besnik Dervishi
Adresa: “Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tiranë” Telefoni: 00355 42337200 info@zdp.al


KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
RAPORTIMI I AUTORITETEVE PUBLIKE MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
2024
Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e kuadrit ligjor në
fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore
të njeriut.
Gjatë vitit 2023, me miratimin e ndryshimeve në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” janë bërë disa shtesa dhe ndryshime të
rëndësishme. Një ndër shtesat më të rëndësishme është neni 24/1, “Detyrimi për bashkëpunim”.
“1. Autoritetet publike bashkëpunojnë me Komisionerin duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave.
2. Autoritetet publike raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë Komisionerit lidhur me veprimtarinë për
zbatimin e kërkesave të këtij ligji, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri.”.
Ky rregullim i shërben kontrollit që Komisioneri ushtron mbi autoritetet publike, evidentimit të problematikave për zbatimin e ligjit, si dhe rritjes
së përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Bashkëpunimi i autoritetit publik me Komisionerin përbën një nga aspektet më të rëndësishme në
drejtim të garantimit të së drejtës për informim dhe përmbushjen e qëllimit të ligjit.
Sa më sipër, kërkon në mënyrë të pashmangshme që titullari i autoritetit publik, si dhe çdo person përgjegjës të ofrojë të gjithë informacionin dhe
mbështetjen që i duhet Komisionerit për të ushtruar detyrat dhe përmbushjen e kompetencave të tij.
Për këtë qëllim, autoritetet publike ngarkohen me detyrimin që të raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 e muajit janar të vitit pasardhës, pranë
Komisionerit lidhur me veprimtarinë për zbatimin e kërkesave të këtij ligji sipas këtij format-pyetesori të miratuar nga Komisioneri.
Autoriteti Publik raporton të dhëna që i përkasin periudhës janar-dhjetor 2024. Raportimi dërgohet pranë Zyrës së Komisionerit brenda datës 31
janar të vitit 2025. Raportimi duhet të plotësohet në çdo pikë të tij me të dhëna të sakta. Të dhënat që mblidhen nga ky pyetësor janë të dhëna
Adresa: “Rr. Abdi Toptani, Nd.5 Tiranë” Telefoni: 00355 42337200 info@zdp.al 1

ANALIZA E TË DHËNAVE

Në vijim, gjenden të përmbledhura në tabela të dhënat agregate të përpunuara nga Zyra e Komisionerit në bazë të vetëdeklarimeve të bëra nga AP. Këto të dhëna i përkasin periudhës janar-dhjetor 2024, për **351** (treqind e pesëdhjetë e një) ose **99%** (nëntëdhjetë e nëntë) e totalit nga **355** (treqind e pesëdhjetë e pesë) autoritete publike të cilave iu dërgua ky format raportimi.

Tabela nr. 1: Numri i raportimeve të mbledhura sipas kategorive të autoriteteve publike

Kategoria	Nr.
Institucione qendrore (Presidenca, Kuvendi, Kryeministria dhe ministrinë)	14
Institucione të pavaruara (kushtetuese ose të krijuara me ligj)	20
Drejtori të Përgjithshme	27
Institucione të tjera varësie (ekzekutive), universitete, ente dhe urdhra profesionale	136
Institucione të sistemit të drejtësisë (gjykata dhe prokurori)	39
Shoqëri tregtare (shteti zotëron shumicën e aksioneve)	31
Njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashki, këshilla qarqesh, prefektura* {*shtuar këto të fundit për efekt të natyrës së veprimtarisë së tyre, edhe pse janë AP në varësi të Këshillit të Ministrave})	84

Tabela nr. 2: Të dhënat e veprimtarisë së autoriteteve publike në fushën e të drejtës për informim për periudhën janar-dhjetor 2024

Nr. total i Autoriteteve Publike	355
Nr. i AP që kanë raportuar	351
Nr. total i kërkesave për informacion publik, regjistruar në Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve periudha janar - dhjetor 2024	11549
Kërkesa nga gazetarë ³	3129
Kërkesa nga përfaqësues të shoqërisë civile ⁴	1540
Kërkesa të deleguara tek një Autoritet tjetër	611
Kërkesa që kanë marrë përgjigje të plotë	9289
Kërkesa të refuzuara	191
Kërkesa që kanë marrë përgjigje të pjesshme/të kufizuar	688

Në rastet e përgjigjeve të refuzuara ose të pjesshme/kufizuara, të dhënat e raportuara lidhur me shkaqet ligjore të kufizimit/refuzimit të dhënies së informacionit janë si më poshtë:

³Për aq sa mund të identifikohen

⁴Për aq sa mund të identifikohen

Tabela nr. 3: Të dhënat agregate të raportuara, lidhur me shkaqet ligjore të kufizimit/refuzimit të dhënies së informacionit

E drejta për një jetë private/mbrojtja e të dhënave personale	43
Sekreti tregtar	20
E drejta e autorit	7
Sekreti tregtar/patentat	1
Siguria kombëtare	27
Parandalimi, hetimi dhe ndjekjen e veprave penale	88
Mbarëvajtja e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor	3
Formulimi i politikave monetare dhe fiskale të shtetit	3
Barazia e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtja e procesit gjyqësor	9
Këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike	22
Mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare	6
Të tjera	162

Zyra e Komisionerit ka mbledhur dhe më parë të dhëna nga autoritetet publike mbi numrin e kërkesave për informacion të regjistruara gjatë një viti kalendarik edhe pse ky detyrim ligjor nuk kishte hyrë ende në fuqi. Në Raportin Vjetor 2023 të Zyrës së Komisionerit janë publikuar të dhënat e veprimtarisë së autoriteteve publike në fushën e të drejtës për informim për periudhën janar-dhjetor 2023 sipas tabelës nr. 4⁵.

Tabela nr. 4: Të dhënat e veprimtarisë së autoriteteve publike në fushën e të drejtës për informim për periudhën janar-dhjetor 2023:

Nr. total i Autoriteteve Publike	332
Nr. i AP që kanë raportuar	304
Nr. total i kërkesave për informacion publik, regjistruar në Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve periudha janar-dhjetor 2024	12323
Kërkesa që kanë marrë përgjigje të plotë	10831
Kërkesa të refuzuara	218


⁵Raporti vjetor 2023 i Zyrës së Komisionerit (fq. 12), https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti_2023.pdf

GJETJET KRYESORE

Nga të dhënat e mësipërme evidentohet se kemi një rritje të numrit të autoriteteve publike të cilat kanë raportuar pranë Zyrës së Komisionerit lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, krahasuar me një vit më përpara. Ky fakt reflekton një rritje të ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit të AP me Zyrën e Komisionerit.

Në një optikë krahasuese midis të dhënave të raportuara gjatë vitit 2023 dhe vitit 2024, vihet re një rënie e lehtë e numrit të kërkesave për informacion të regjistruara nga AP. Kjo tendencë vihet re edhe po t’i referohemi numrit të ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit, e cila gjithashtu ka pësuar një rënie të lehtë krahasuar me një vit më përpara (*grafiku nr. 1*). Nga një anë kemi shtimin e autoriteteve që kanë raportuar pranë Zyrës së Komisionerit, nga ana tjetër rezultojnë se ka një ulje të numrit të kërkesave për informacion: nga **12323** (dymbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tre) kërkesa të deklaruara për vitin 2023 nga **304** (treqind e katër) autoritete publike, në **11549** (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) kërkesa për informacion të deklaruara për vitin 2024 nga **351** (treqind e pesëdhjetë e një) autoritete, pra **774** (shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) kërkesa më pak ose **6%** (gjashtë) më pak se një vit më parë.

Grafiku nr. 1: Numri i ankesave të administruara nga Zyra e Komisionerit me objekt “cenim të të drejtës për informim”



Duke bërë një krahasim me vetëdeklarimin vullnetar për vitin 2023, rezultojnë në terma relativë një normë prej **92%** (nëntëdhjetë e dy) të AP që kanë raportuar pranë Zyrës së Komisionerit, që do të thotë se për vitin 2024 kemi rritje në këtë tregues në **99%** (nëntëdhjetë e nëntë). Një numër më i vogël kërkesash për informacion të regjistruara nga ana e autoriteteve publike, shkon në të njëjtën linjë me prirjen në rënie të ankesave të paraqitura nga qytetarët pranë Zyrës së Komisionerit sipas grafikut nr.1.

Në raportimin e vitit 2024, një kërkesë e re e Zyrës së Komisionerit ishte evidentimi i kategorisë së kërkuësve të informacionit⁶, ku për vitin 2024 rezultoi se **3129** (tre mijë e njëqind e njëzet e nëntë) ose **27%** (njëzet e shtatë) të kërkesave për informacion janë depozituar nga gazetarë dhe **1540** (një mijë e pesëqind e dyzet) ose **13%** (trembëdhjetë e tre) të kërkesave për informacion janë depozituar nga përfaqësues të shoqërisë civile. Për sa më sipër, rezultoi se **40%** (dyzet) e kërkesave për informacion/dokumentacion publik janë dërguar nga organe mediatike dhe/ose gazetarë apo organizata të shoqërisë civile, ndërkohë që **60%** (gjashtëdhjetë) e tyre, çka përbën dhe pjesën më të madhe të kërkesave, janë paraqitur nga qytetarë.

Tabela nr. 5: Kategoritë e ankuesve

Ankuesit	Viti 2024 - 939 ankesa	% mbi totalin e ankësive
Qytetarë	393	42%
OSHC	181	19%
Gazetarë	365	39%

Referuar tabelës së më sipërme, rezultoi se ankesat e administruar nga Zyra e Komisionerit gjatë vitit 2024, kanë një prirje të përmbysuar në raport me kërkesat, pra në **58%** (pesëdhjetë e tetë) të rasteve ato janë depozituar nga gazetarë apo organizata të shoqërisë civile dhe në **42%** (dyzet e dy) nga qytetarë.

Autoriteteve publike iu la mundësia të shpreheshin edhe nëse ndryshimet e fundit ligjore të LDI, specifikisht, *lidhur me përgjegjësinë e çdo personi, i cili me veprimet ose mosveprimet e tij shkel dispozitat e këtij ligji*, kishin ndikuar në trajtimin më të shpejtë të kërkesave për informacion dhe dhënien e përgjigjeve sa më të plota. Nga të dhënat e administruara nga raportimi, shumica e AP kanë pohuar se ky ndryshim ligjor ka patur një ndikim pozitiv në përshpejtimin e procesit të trajtimit të kërkesave, ashtu si dhe në përmbushjen e detyrimit për dhënie të përgjigjeve sa më të plota.

Zyra e Komisionerit nëpërmjet raportimit iu kërkoi autoriteteve publike të shpreheshin edhe mbi nevojat e tyre lidhur me udhëzime apo trajnime të ndryshme nga ana e saj, të cilat u adresuan përgjatë vitit 2025 dhe në vazhdim.

⁶Për aq sa mund të identifikohet

PËRFUNDIME

Raporti paraqet një panoramë të përmbledhur lidhur me zbatimin e legjislacionit për të drejtën për informim që do t'i shërbejë Zyrës së Komisionerit në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe kompetencave të saj ligjore, si dhe përbën një bazë të mirë informacioni për kërkimin social dhe shkencor në fushën e të drejtës për informim, po ashtu mundëson përditësimin e portalit pyetshtetin.al (të dhënat e koordinatorëve) apo listën e AP në Shqipëri (në faqen e institucionit www.idp.al), duke lehtësuar gjetjen dhe përpunimin e këtij informacioni.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson në tërësi se transparencja proaktive e autoriteteve publike (Programi i Transparencës dhe Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve), referuar edhe *“Indekseve të transparencës proaktive 2024”*⁷, është përmirësuar lehtë, duke ndikuar edhe në uljen e numrit total të kërkesave për informacion/dokumentacion me karakter publik prej 7% (shtatë) në 2024 në raport me vitin 2023.

Nëpërmjet këtij raportimi, Zyra e Komisionerit verifikoi edhe raste të ndryshimit të të dhënave mbi koordinatorët në krahasim me ato të administruara më parë. Përditësimi i këtyre të dhënave (në vazhdimësi) në portalin pyetshtetin.al është një detyrë e Zyrës së Komisionerit. Të dhënat e koordinatorit qëndrojnë në portal për aq kohë sa ushtrohet prej tij/saj kjo detyrë. Ashtu si nga ana tjetër, secili AP mbart detyrimin ligjor që të njoftojë për çdo ndryshim të mundshëm të koordinatorit, si një nga elementët kryesorë të transparencës proaktive.

Duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët që ndikojnë në këtë situatë, si përgjegjshmëria dhe angazhimi, përgatitja profesionale, funksionimi dhe koordinimi i njësive brenda strukturës së AP, apo dhe teknologjia/digjitalizimi në dispozicion të tyre, konstatojmë një prirje pozitive në konsolidimin e kulturës së transparencës së autoriteteve publike. Për këtë të fundit, ky element thelbësor i mirëqeverisjes nuk është më përmbushje mekanike e kuadrit rregullator në fuqi, por krijimi i të gjitha kushteve për ushtrimin praktik dhe proaktiv të të drejtës individuale të çdo qytetari, ashtu si edhe të grupeve të interesit, në funksion të të mirës së përbashkët.

Në këtë kontekst, vijon të mbetet i rëndësishëm funksioni trajnues i Zyrës së Komisionerit si për koordinatorët ashtu edhe për nëpunësit/punonjësit e tjerë të përfshirë në procesin e transparencës, referuar edhe përgjigjeve të këtij raportimi. Përveçse një detyrim tjetër ligjor, kjo qasje ka për qëllim që të rrisë njohuritë në funksion të zbatimit të *“testit të interesit publik”* në raport me trajtimin e kërkesave për informacion/dokumentacion publik që u përkasin çështje/aplikimeve për marrjen e shërbimeve individuale. Nga ana tjetër, trajtimi i rasteve që mund të kufizohen sipas parashikimeve të nenit 17 të LDI, është po ashtu me shumë rëndësi për thellimin e kapaciteteve profesionale në administratën publike shqiptare.

⁷<https://idp.al/raporte-monitorimi-te-transparences-2024/>

Gjatë vitit 2025, Zyra e Komisionerit programoi një seri trajnimesh në mënyrë që të adresojë kërkesat e qytetarëve dhe AP, kombinuar kjo edhe me veprimtarinë tjetër të Zyrës së Komisionerit, atë të shqyrtimit administrativ të ankesave. Nëpërmjet, kësaj qasje synohet jo vetëm forcimi i mbështetjes dhe rritja e njohurive mbi parashikimet e LDI e kërkuësve, e koordinatorëve, por edhe përmirësimi i vazhdueshëm dhe në tërësi i transparencës proaktive të autoriteteve publike.

Zyra e Komisionerit vlerëson që nëpërmjet këtij ushtrimi të përvitshëm të konsolidojë dhe nxisë përmirësimin në vazhdimësi të transparencës së autoriteteve publike. Të dhënat e mbledhura sipas këtij standardi përbëjnë informacion me karakter publik në kuptim të LDI dhe publikohen, specifikisht, në formën që i janë raportuar Zyrës së Komisionerit, njëkohësisht, edhe në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 33/2022 *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*. Njëkohësisht, këto të dhëna janë të rëndësishme, ashtu si edhe *“Indekset vjetore të transparencës proaktive”*, pasi citohen dhe merren në konsideratë në raporte të organizatave/projekte të ndryshme vendase dhe të huaja që monitorojnë veprimtarinë e autoriteteve publike shqiptare.